

## Gabimet më të shpeshta gjatë mjeljes

*Mjelja e gabuar ka shpesh efekte dëmtuese në shëndetin e gjirit. Ndërthurja mes rendimentit të qumështit dhe gradës së mjeljes së gjirit merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe, kur bëhet fjalë për rritje të rendimentit të qumështit. Këshilluesja në fushën e mjeljes, Kathrin Lincke, Türkheim, do të sqarojë më poshtë se cilat probleme hasim më shpesh në praktikë dhe si mund të zgjidhen ato.*



### Problemet tipike të mjeljes dhe shkaqet e tyre

Formimi dhe rrjedhja e qumështit janë procese shumë komplekse të komanduara nga hormonet. Prej mijëra vitesh ato kanë evoluar në mënyrë të tillë, që të sigurojnë ushqyerjen e brezit në vijim dhe kanë siguruar si rrjedhojë mbijetesën e kësaj specie.

Nëse njeriu do të ishte „shpikësi“ i lopës, në kohët e sotme në vend të të çarave të ndjeshme të kanalit të qumështit, do të kishte ventila tek thithat. Meqë kjo gjë për fat të keq (apo për fat të mirë) nuk është kështu, atëherë gjatë mjeljes duhet të merren parasysh disa varësi fiziologjike.

## **Të përshtatësh teknikën e mjeljes me lopët**

Sa më shumë rendimente të larta që kërkojmë nga lopët, aq më e rëndësishme është që t'iu krijojmë lopëve kushte të mira mbajtjeje, që të përkojnë me kërkesat e tyre natyrore. Ai që synon të mjelë për një kohë të gjatë një gji të shëndetshëm, duhet të ruajë mekanizmat imunitar natyral ndaj infeksionit që i ka vetë lopa. Prandaj është e rëndësishme, që të përshtatet teknika e mjeljes sipas nevojave të lopës dhe të mos spekulohet me faktin, që lopa do të mund të pranojë edhe teknikën më agresive të mjeljes dhe të vazhdojë njëkohësisht të japë mjaftueshëm qumështin e kërkuar.

## **Kur mund të quhet një teknikë mjeljeje agresive?**

Përgjigjen për këtë pyetje na e japin thithat e gjirit tek lopa. Shikoni thithat e mëshqerrës dhe vëzhgoni ndryshimin e tyre gjatë laktacionit. Forcimi, rrathë të bardhë dhe transformimi i formave apo madje dhe rrudhosjet e thithave nuk janë natyrore, por një reaksion i qelizave ndaj sforcimit të madh mekanik.

Çfarë dihet prej kohësh është që thithat e gjirit dëmtohen veçanërisht gjatë mjeljes së verbër. Në këtë rast vakumi depërton direkt tek gjiri dhe pajisja mjelëse ushtron për shkak të diferencës së madhe të vakumit një presion shumë të lartë mekanik tek thithat. Për fat të keq „Teknika moderne e mjeljes“ edhe në ditët e sotme, gjatë gjithë procesit të mjeljes, krijon pothuajse të njëjtat kushte vakumi si tek mjelja e verbër, domethënë vakumi është stabil në ritmin e thithjes dhe të nxjerrjes së ajrit. Megjithatë ajo që dëshirohet të arrihet tek procesi „thithja“, ngarkon thithat gjatë procesit të nxjerrjes së ajrit. Sa më i lartë të jetë presioni në majat e thithave dhe sa më i gjatë të jetë procesi i mjeljes, aq më shumë dëmtohen veshjet e brendshme të kanalit të qumështit. Por nëse “porta hyrëse“ e gjirit është e dëmtuar, atëherë sëmundjet gjejnë rrugë të lirë për t’u përhapur. Sa më shumë stimulues sëmundjesh të depërtojnë nga mjedisi i papastër tek gjiri i lopës, aq më fortë duhet të reagojë organizmi i lopës duke formuar qelizat imunitare. Fillimisht rritet vetëm sasia e qelizave somatike, por në rastin e pranisë së lartë infeksioni në stallë (muajt e verës, lopë të tjera me gji të sëmurë) apo në rastin e ngarkesave stresuese, shkaktohen infeksione të gjirit me të gjitha pasojat që dihen tashmë.

## **Si ta parandalojmë këtë gjë?**

Kontrolloni rregullisht vakumin e sistemit të mjeljes, ventili rregullator i ndotur mund të përbëjë shkak për çrregullimin e vakumit në mjelje. Përpiquni që gjatë mjeljes të keni mundësisht një vakuum të ulët. Nëse në impiantin e mjeljes nevojiten më tepër se 42 kPa

vakum, pasi përndryshe shkaktohen probleme me mjeljen, në këtë rast duhet të kërkohen shkaqet e këtij problemi dhe të mënjanoen.

### **Probleme në vendosjen e pajisjeve mjelëse**

Shumë shpesh problemet e vendosjes së pajisjeve të mjeljes (gotat e mjeljes) shfaqen direkt pasi ato janë vendosur tek gjiri. Për shkak se stimulimi ka qenë shumë i shkurtër apo nuk është realizuar, gjiri i lopës nuk çliron qumështin. Gotat e mjeljes nuk mund të qëndrojnë në thithat bosh dhe të dëmtuara sepse thithin ajrin dhe shkaktojnë uljen e vakumit në sistemin mjelës. E njëjta gjë ndodh edhe kur thithat pastrohen me ujë dhe nuk thahen. Për këtë arsye është e rëndësishme, që pajisjet mjelëse të vendosen vetëm në thithat e gjirit të thata dhe “të shëndetshme”.



Në momentet e parastimulimit mekanik të gjirit nuk duhet të milet qumësht. Koha e stimulimit dhe e pritjes është në proporcion me peshën trupore e fizike të kafshës, pasi oksitocina, që është përgjegjëse për çlirimin e qumështit duhet të transportohet nëpërmjet enëve të gjakut nga gjëndrat e trurit tek gjiri.

*Fig. 1: Thitha të dëmtuara rëndë si pasojë e kushteve jo të mira në mjelje*

### **Mos kurseni kohë gjatë stimulimit**

Testoni nevojën për stimulim të lopëve, duke realizuar matjen e kohës nga prekja e parë dhe deri kur ndjeni, që ka rrjedhje qumështi në thithat e gjirit. Shumë lopë Holstein Friesian, në ditët e sotme, kanë nevojë për mbi 90 sekonda kohë për stimulim ashtu si dhe lopët Simental. Ai që kërkon të kursejë kohë në fillimin e mjeljes, do të humbas shumë kohë në vendosjen e pajisjeve mjelëse si dhe gjatë mjeljes me rrjedhje të pakët të qumështit, dhe krahas kësaj do të shkaktojë dhe dëmtime të thithave të gjirit.

Shpesh tubat e shkurtër të qumështit janë të fortë dhe të ashpër. Pajisja mjelëse nuk është praktike për të mjelë çdo thithë të gjirit. Probleme të tjera nga tubat e shkurtër të qumështit mund të jenë mos krjimi i kontakteve midis gotave të mjeljes dhe pjesëve të caktuara të gjirit.

### **Pozicionimi i saktë i pajisjeve mjelëse**

Nëse ka probleme të vazhdueshme me vendosjen e gotave të mjeljes në çerek-gjiret e përparmë, atëherë duhet të përmirësohet pozicionimi i pajisjeve mjelëse. Nëse tubi i qumështit dhe i ajrit janë në dysHEME, atëherë mbingarkohen veçanërisht gotat mjelëse të përparme dhe gotat e mjeljes së pasme nuk kanë ngarkesë, madje shtyhen lart.

Ky problem zgjidhet lehtësisht duke ngritur tubin e qumështit në drejtim të pikës mbledhëse. Në dhomën e mjeljes zgjidhja më e thjeshtë është një çengel konik. Më mirë, por edhe më e shtrenjtë është mënyra me krahët lëvizës së impiantit të mjeljes, ku tubi i qumështit tërhiqet lehtë përpara dhe mund të çohet lart.

Në stallat me sistem të lidhur mund të përdoret një lidhëse prej gome që vendoset rreth tubit të qumështit dhe atij të ajrit dhe një çengel ekstra ku mund të varet bidoni i mjeljes në kapësen e pulsatorit. Në këtë mënyrë tubat mund të kalojnë para ose mundësisht afër lopës, me qëllim që pajisja mjelëse të mos jetë shumë e ngatërruar, tubat mos të prekin mbi dysheme dhe çerekgjiret e pasme të kenë ngarkesën që u takon. Duke patur një ngarkesë të ekuilibruar tek gotat e mjeljes gjiret milen plotësisht në të njëjtën kohë, kohët e mjeljes shkurtohen dhe në çerekgjiret e pasme do të ketë më pak mjelje të vonë. Njëkohësisht tubi i



ngritur i qumështit edhe në rastin e e rendimentit të ulët të qumështit shkakton luhatje të vakumit në mjelje tek thithat. Gotat e mjeljes dhe pajisjet e mjeljes lëvizin më fort, kështu që diferenca e presionit pakësohet. Në këtë mënyrë thithat dëmtohen më pak.

**Fig. 2:** Kondicion i mirë i thithave të gjirit

### **Gjiri duhet të jetë i çtendosur**

Të gjitha ato që u përmendën më lart luajnë rol edhe në çtendosjen e muskulaturës së gjirit. Nëse gjiri është i çtendosur dhe i plotë, qumështi mund të rrjedhë më shpejt nga gjendrat e sipërme të gjirit nëpërmjet kanaleve të imëta të qumështit. Çdo lloj stresi apo dhimbje gjatë procesit të parapërgatitjes, çlirojnë hormone në gjak, të cilat ndikojnë negativisht në çlirimin dhe në dhënien e qumështit. Nën ndikimin e këtyre hormoneve, muskulatura tendoset, gjiri forcohet dhe rrugët e qumështit ngushtohen. Duke përmbledhur të gjitha problematikat lopa është nën efektin e hormoneve të stresit, në këtë mënyrë kufizohet efekti i oksitocinës.

### ***E shprehur më saktë: Lopët nuk lejojnë të milen plotësisht.***

Por mos i kërkoni shkaqet vetëm tek teknika e mjeljes. Edhe lopët me probleme thundrash, me probleme në metabolizëm, me gjymtyrë të enjtura dhe me sëmundje të tjera nuk janë aspak të çtendosura në dhomën e mjeljes dhe për këtë shkak nuk mund të milen asnjëherë plotësisht. Gjithashtu një rol luan edhe nxitimi dhe trajtimi jo i mirë i lopëve, mbledhja e lopëve drejt impiantit të mjeljes me trembje korenti, rrugë tepër të lëmuara apo edhe dhoma mjelje të ngushta, ngjeshje pas njëra-tjetrës apo pajisje mjelëse tepër agresive. Mjelja u

shkakton shumë dhimbje, kur gominat e gotave të mjeljes janë shumë të mëdha apo shumë të ashpra, kur vakumi është tepër i lartë procesi i hapjes dhe mbylljes së gotës së mjeljes është shumë e shkurtër (Faza – d > 180ms). Në rastet ekstreme lopët shpesh e hedhin me forcë pajisjen mjelëse nga gjiri. Në këtë rast e arsyeshme do të ishte kontrollimi i të gjitha burimeve të mundshme të gabimeve si dhe marrja e masave të duhura.



*Fig. 3: Dora duhet të kalojë mes lopës dhe skeletit të mjeljes, përndryshe është ngushtë për lopën*

### **Humbje të energjisë elektrike**

Shumë probleme vihen re shumë vonë. Kështu për shembull një dhomë mjeljeje mund të funksionojë normalisht për vite të tëra, derisa të shfaqen probleme në tokëzim (tharje, ndryshkje...) dhe kështu efektet e humbjes së energjisë janë më të dukshme. Për këtë arsye duhet të keni kujdes krijimin e ekulibrit të potencialit tek të gjitha elementët përcjellës të energjisë në dhomën e mjeljes dhe gjithashtu vendosni një tubacion mjaft rezistent në tokëzimin e ndërtesës. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të shmangni rrezikun e mundshëm të rrymës së pakontrolluar tek pajisjet e gradës së lartë tek dhoma e mjeljes (elektropulsatorët, matësit e sasisë së qumështit, indikatorët e rrjedhjes së qumështit, etj.) apo për shembull kalimi në gropën e plehut.


### **Dhomat e mjeljes si shkaktarë të problemeve në mjelje**

Shpesh humbjet e pakontrolluara të energjisë elektrike merren si shkak kryesor, por në fakt problemi ndodh sepse dhoma e mjeljes është tepër e ngushtë. Shkak kryesor nuk është vetëm mungesa e hapësirës përpara, por madje shpesh vendi mund të jetë shumë i ngushtë edhe tek barku i lopës, kështu ato pozicionohen në një kënd shumë të ngushtë, apo ndoshta dhe skeleti i mjeljes është shumë larg barkut të lopës. Vendet e vjetra të ngrënies apo vendet, ku futet koka, janë po aq shqetësuese sa edhe distanca e gabuar e skeletit të

montuar para gropës së mjeljes. Lopët që janë të shqetësuara, që lëvizin vazhdimisht andej-kënde, që qëndrojnë shtrembër, që shtynjë lopët e tjera tregojnë shenja se diçka duhet të ndryshojë. Nëse në hapësirën mes skeletit të mjeljes dhe lopës nuk ka vend aq sa të kalojë dora, atëherë patjetër duhet të ndryshojë diçka.

### Kontrolloni gominat e thithave


Nëse mbetjet e qumështit në gjirin e lopës janë gjithnjë e më të mëdha, atëherë përgjegjëse për këtë gjë janë gominat e gotave të mjeljes. Nëse hapjet tek koka janë zgjeruar për shkak të pastrimit të vazhdueshëm, pastrimit të keq nga brenda apo kanë qenë gjithë kohën të mbyllura, atëherë edhe pse kemi të bëjmë me një stimulim të mirë, këto gomina nuk do të mund të qëndrojnë gjatë në gjirin e lopës. Edhe nëse nuk ka probleme me vendosjen, këto gomina thithash rezultojnë të mëdha. Shumë shpejt tek thithat shfaqen enjtje, që e bëjnë gjithnjë e më të pamundur vendosjen e gominave. Rrjedhja e qumështit bëhet gjithnjë e më e ngadaltë derisa ndalon krejt, pavarësisht se në gjirin e lopës ka ende shumë qumësht. Kontrolloni vazhdimisht gjendjen e gominave të gjirit dhe bëni përshtatjet e nevojshme në tufë.



**Fig. 4:**  
*Nëse gjerësia e vendit të mjeljes është më pak se 1,20 m pjesa ballore duhet të zhvendoset në mur.*



**Fig. 5:**  
*Vendosje optimale e tubave, por për Simental gota mjeljeje shumë të lehta*



**Fig.6:**  
*Vendosje e mirë e tubave, mjafton dhe një çengel*

### Përmbledhje

Ai që dëshiron të identifikojë problemet në mjelje, duhet të vëzhgojë si duhet dhe me shumë kujdes procesin e mjeljes. Kondicioni i gjirit, grada e mjeljes dhe çtendosja e gjirit flasin shumë për cilësinë e mjeljes. Gabimet më të shpeshta janë: vendosja e parakohshme e pajisjeve mjelëse direkt në gjirin e lagur, një ngarkesë jo e ekuilibruar e gotave të qumështit dhe shpërndarje jo e favorshme e tubave. Lopëve nuk u mungon hapësira e nevojshme vetëm në impiantet e vjetra të mjeljes, por edhe në ato të rejtat.

Shpesh herë vakumi është i lartë pa qenë e nevojshme, dhe gotat e mjeljes në varësi të fabrikatit, të lehta në peshë sidomos për lopën Simental. Vendosija e gominave të gotave të mjeljes të përshtatshme dhe të rënda dhe gjithashtu gomina qumështi të buta përmirësojnë dukshëm procesin e mjeljes.

Probleme të vërteta gjatë procesit të mjeljes, fermat kanë nëse të gjitha gabimet e përmendura më sipër shfaqen njëkohësisht, apo krahas kësaj ka dhe mangësi shtesë si pendencë e pakët e impiantit, montimi i tubave të ajrit me shumë harqe 90° apo dhe një pastrim i pamjaftueshëm i gominave të gjirit. Këshillime të gabuara janë dhënë në atë rast, kur fermeri ndërhyr vetëm, kur janë shtuar infeksionet e gjirit në masë dhe numri i qelizave somatike është rritur. Në këtë rast kemi të bëjmë me kosto shumë të larta, dhe mund të zgjasë shumë kohë derisa të riparohen të gjitha gabimet e bëra më parë.